



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njesia Org. Org.Jedinica Org Unit	02	Nr.Prot: Broj Prot: Prot.No	05-9910
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	-5-	Data: Datum: Date:	18/12/2024
Prishtinë / a			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva


PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: IDENTIFIKIMI, DEKLARIMI DHE RAPORTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

PËRMBAJTJA: PROCESI DHE PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT, DEKLARIMIT DHE RAPORTIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT, DUKE PËRFSHIRË PERSONAT DHE MEKANIZMIN PËRGJEGJËS

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 17.12.2024
AUTOR: GP
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 25

APROVUAR: Dr. Naim Bardiqi
Sekretar i Përgjithshëm, MSh


v.v



QËLLIMI	<ul style="list-style-type: none"> • QËLLIMI I KËTIJ DOKUMENTI ËSHTË TË PËRSHKRUAJË PROCEDURAT PËR IDENTIFIKIMIN, ZBULIMIN DHE MENAXHIMIN E KONFLIKTEVE AKTUALE, POTENCIALE OSE TË PERCEPTUARA TË INTERESIT; DHE PËR TË ZBUTUR RASTET E KONFLIKTIT ME INTERES. • KY DOKUMENT SIGURON GJITHASHTU QË TË GJITHË PUNONJËSIT E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË JANË TË VETËDIJSHËM PËR DETYRIMET E TYRE, ANDAJ ZBULOJNË DHE MENAXHOJNË KONFLIKTET AKTUALE, TË MUNDSHME OSE TË PERCEPTUARA TË INTERESIT. • KJO PROCEDURË ZBATOHET PËR TË GJITHË PUNONJËSIT E MSH-SË, PËRFSHIRË PUNONJËSIT ME KOHË TË PLOTË, ME KOHË TË PJESSHME, KONTRAKTORËT, KONSULENTËT DHE KËDO QË PUNON NËN AUTORITETIN E MSH-SË.
PËRKUFIZIME	<ul style="list-style-type: none"> • KONFLIKT INTERESI: NJË SITUATË KU INTERESAT PERSONALE, FINANCIARE, OSE PROFESIONALE TË NJË INDIVIDIT MUND TË NDIKOJNË OSE DUKET SE NDIKOJNË NË VENDIMMARRJET E TIJ NË EMËR TË ORGANIZATËS. • DEKLARIM: PROCESI I INFORMIMIT TË ORGANIZATËS PËR ÇDO KONFLIKT TË MUNDSHËM INTERESI.
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ul style="list-style-type: none"> ▪ LIGJI NR. 06/L -011 PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONIT PUBLIK; ▪ LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE; ▪ LIGJI NR. 06/L -085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE. ▪ LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
I	Identifikimi i konflikteve të interesit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Çdo punonjës i institucionit duhet të shqyrtojë aktivitetet dhe marrëdhëniet e tij për të identifikuar konfliktet e mundshme të interesit; 2. Shembuj të konflikteve të interesit përfshijnë, por nuk kufizohen në: <ul style="list-style-type: none"> - marrëdhënie financiare me furnizues ose klientë; - marrëdhënie familjare ose miqësore me persona që kanë interesa në organizatë; 3. Punonjësit janë të detyruar të zbulojnë çdo konflikt aktual, potencial ose të perceptuar të interesit në mundësinë më të hershme; 4. Nëse punonjësi ka dyshime, duhet të konsultohet me eprorin e tij ose Divizionin e Burimeve Njerëzore për sqarime; 5. Punonjësi do të sigurojë që mbikëqyrësi/menaxheri i tyre të jetë në dijeni të konfliktit në mënyrë që të jetë efektiv; 6. Punonjësit duhet të respektojnë çdo udhëzim të ligjshëm dhe të arsyeshëm të lëshuar në lidhje me menaxhimin e një konflikti interesi të raportuar.
II	Deklarimi i Konfliktit të Interesit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Punonjësi duhet të raportojë çdo lidhje ose marrëdhënie që ka me persona që janë kriminelë të njohur, ose që janë të dyshuar ose perceptuar se janë të përfshirë në aktivitete kriminale duke plotësuar një Raport të Konfliktit të Interesit; 2. Punonjësi duhet të deklarojë konfliktin e interesit me shkrim drejtpërdrejtë te Zyrtari përgjegjës për emërimin e tij në vendimmarrje; 3. Punonjësi duhet të plotësojë Formularin e Deklarimit të Konfliktit të Interesit (shtojca 1), sa më shpejt që të identifikojë një konflikt të mundshëm; 4. Formulari i nënshkruar nga deklaruesi dhe Zyrtari përgjegjës për emërimin e punonjësit në vendimmarrje duhet të dorëzohet brenda 3 ditëve nga identifikimi i konfliktit të mundshëm; 5. Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar, duhet t'i dorëzohet Zyrtarit përgjegjës për regjistrim të konfliktit i caktuar me Vendim nga ZKA (zyrtar i Divizionit të Burimeve Njerëzore).
III	Vlerësimi dhe Vendimmarrja	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zyrtari Përgjegjës për emërimin e punonjësit në vendimmarrje, do të shqyrtojë Formularin e Deklarimit të punonjësit brenda 2 ditëve të punës nga dita e deklarimit; 2. Nëse është e nevojshme, do të ketë konsultime me individin për të marrë informacione shtesë; 3. Nëse konfirmohet një konflikt interesi, do të merren masat e duhura për të minimizuar ndikimin e tij, të tilla si: <ul style="list-style-type: none"> - shmangia e individit nga proceset vendimmarrëse që lidhen me konfliktin; - rishikimi i vendimmarrjeve nga një palë e tretë e pavarur e emëruar nga ZKA ad-hoc;

		<p>4. Zyrtari përgjegjës për emërimin e punonjësit në vendimmarrje duhet të vendos:</p> <ul style="list-style-type: none"> - punonjës in me konflikt interesi të deklaruar t'ia kufizojë veprimin e tij në vendimmarrje që lidhen me atë konflikt për aq kohë sa ekziston konflikti; - punonjës in me konflikt interesi të deklaruar do ta largojë nga të gjitha detyrat që lidhen me atë konflikt për aq kohë sa ekziston konflikti; <p>5. Për vendimin e marr nga vendimmarrësi duhet të informohet edhe deklaruesi;</p> <p>6. Deklaruesi për konflikt të interesit ndaj vendimmarrjes mund të ankohet në instancat publike relevante;</p> <p>7. Mbrojtja e të dhënave personale për deklaruesin është e përcaktuar me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>
IV	Raportimi i konflikteve të interesit	<p>1. Të gjitha raportet dhe dokumentet e lidhura me konfliktet e interesit duhet të regjistrohen dhe ruhen në një regjistër të posaçëm nga Zyrtari përgjegjës për regjistrim të konfliktit;</p> <p>2. Institucioni do të kryejë rishikime periodike për të siguruar që të gjitha deklaramet e konfliktit të interesit janë të azhurnuara dhe të menaxhuara siç duhet;</p> <p>3. Punonjësit, punonjësit me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, kontraktorët, konsulentët dhe këdo që punon nën autoritetin e MSh-së: duhet të përditësojnë deklaramet e tyre çdo vit ose sa herë që ndodh një ndryshim në situatën e tyre personale.</p>
V	Përgjegjësitë	<p>1. Punonjësit, punonjësit me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, kontraktorët, konsulentët dhe këdo që punon nën autoritetin e MSh-së: Për të identifikuar dhe deklaruar konfliktet e mundshme të interesit;</p> <p>2. Zyrtari përgjegjës për regjistrim të konfliktit: Për të mbajtur një regjistër për deklaramet e konflikteve të interesit dhe për të siguruar mbrojtjen e të dhënave të deklaruesit.</p>
VI	Sanksionet	<p>1. Mos deklarimi i konflikteve të interesit mund të rezultojë në masa disiplinore, pa u kufizuar në pezullimin ose largimin nga detyra;</p> <p>2. Deklarimi i rremë ose i pavërtetë i konflikteve të interesit do të trajtohet me seriozitet dhe mund të rezultojë në masa disiplinore.</p>

Shtojca 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Deklarimin rast për rast i interesave private të zyrtarit, deklaroj si në vijim:

DEKLARATË E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaruesi z/znj. _____

Pozita Deklaruese: _____

Zyrtari përgjegjës për emërimin e _____
punonjësit në vendimmarrje:

Në cilësinë e _____, me përgjegjësi të plotë morale, penale deklaroj se kam konflikt interesi sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, i cili mund të vë në dyshim kryerjen e detyrës si anëtar/zyrtar _____.

Nënshkrimi i deklaruesit:

Data: _____

Qarko: Aprovim / Refuzim

Nënshkrimi i zyrtarit përgjegjës

Pranoi: Zyrtari përgjegjës për regjistrim të konfliktit
